



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Seanca plenare e Kuvendit

SP-011

Prishtinë, më 14 dhjetor 2017 dhe 25 janar 2018

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2017 DHE 25 JANAR 2018**

Seancën e kryesoi Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarja e Kuvendit, Mufera Shinik.

Kryesuesi i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2017.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Avdullah Hoti, Xhevahire Izmaku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Teuta Haxhiu, Milaim Zeka, Rexhep Selimi, Hajdar Beqa, Hykmete Bajrami, Kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri Pal Lekaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me hekurudhën në qytetin e Ferizajt.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Faton Topalli i parashtoi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me implementimin e Kartonit të Gjellbër.
Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planifikimet e Ministrisë së Infrastrukturës për përfundimin e punimeve në rrugën Deçan - Plavë.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtoi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me procedimin e Projektligjit për Qeverinë.
Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Liburn Aliu i parashtoi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me lejen ndërtimore për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Hani i Elezit.

Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Liburn Aliu i parashtoi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me lejet ndërtimore për ndërtimet e kategorisë III, të lëshuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtoi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me mbrojtjen e objekteve me vlera historike në Qendrën Historike të Prizrenit.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtoi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me planifikimet buxhetore për vitin 2018 për zbatimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtoi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me komisionin për kategorizimin e veteranëve të UÇK-së dhe planifikimet buxhetore për vitin 2018 për zbatimin e Ligjit për veteranët e të UÇK-së.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Imet Rrahmani i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me pagesat e rrezikshmërisë për punëtorët mjekësorë të ndihmës së parë.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me koeficientin e pagave për infermierët me shkollim universitar.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me petitionin e banorëve të fshatit Atmaxhë të Komunës së Prizrenit kundër privatizimit të tokave bujqësore në këtë fshat.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Lutfi Zharku i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me një deklaratë të ministrit z. Lekaj të raportuar nga mediet, në lidhje me nënshkrimin e projekteve nga ana e deputetit Lutfi Zharku gjatë kohës kur ishte ministër i Infrastrukturës.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me qëndrimin e tij për Marrëveshjen për Drejtësinë, të nënshkruar nga ish-kryeministri Isa Mustafa.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 23, 24, 29, 30 nëntor dhe më 5, 6, 7, 10 dhjetor 2017.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndërmarrjet sociale diskutuan deputetët: Besa Baftiu, në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të GP të LVV-së; Haxhi Avdyli, në emër të GP të LDK-së; Bekim Haxhiu, në emër të GP të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të GP të Listës serbe; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”; Adem Mikullovc, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Faton Topalli, Lirije Kajtazi,

Glauk Konjufca, Naser Rugova, Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndërmarrjet sociale.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-022 për ndërmarrjet sociale.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratim e tij.

Kryesuesi e ftoi Avokatin e Popullit që ta para deputetëve ta paraqesë raportin.

Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016, fjalimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

Lidhur me raportin të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016, diskutuan deputetët: Duda Balje, në emër të Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe në emër të GP “6+”; Lumir Abdixhiku në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Lirije Kajtazi, në emër të GP të LDK-së; Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të PDK-së; Miljana Nikoliq, në emër të GP të Listës serbe; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të Nismës për Kosovën; Arbërie Nagavci, Korab Sejdiu, Luljeta Veselaj-Gutaj, Milaim Zeka, Veton Berisha, Mirjeta Kalludra, Bekim Haxhiu, Ganimete Musliu, Daut Haradinaj, Time Kadrijaj, Islam Pacolli, Blerta Deliu-

Kodra, Bilall Sherifi, Xhevahire Izmaqu dhe Enver Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesja në mungesë të kuorumit i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 17:15.

* * *

E enjte, më 25 janar 2018

Vazhdimi i seancës plenare, filluar më 14 dhjetor 2017

Seancën plenare e kryesoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala.

Kryetari e hapi Sesionin pranveror të punimeve të Kuvendit për vitin 2018.

Ai i njoftoi deputetët për vendimet e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me zëvendësimin e deputetëve nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje”, z. Shemsi Syla në vend të ish-deputetit Mytaher Haskuka, dhe z. Salih Zyba në vend të ish-deputetit Qëndron Kastrati, të cilët gjithashtu me këtë rast u ftuan për ta dhënë betimin, si dhe e nënshkruan deklaratën e betimit.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës të papërfunduara nga seanca plenare, e filluar më 14 dhjetor 2017:

5. Votimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë raport kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 14 dhjetor 2017, por për mungesë të kuorumit nuk është proceduar me votimin e tij.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016

Kryesuesi (seancën e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala) i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ai e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit funksional.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit FunkSIONAL lidhur me raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016.

Lidhur me raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016, diskutuan deputetët: Dardan Sejdiu, në emër të GP të LVV; Lumir Abdixhiku, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët: Islam Pacolli, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Shqipe Pantina, Faton Topalli dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	67,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e saj.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit FunkSIONAL lidhur me kërkesën Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018.

Lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018, diskutuan deputetët: Dardan Sejdiu, në emër të GP të LVV; Lumir Abdixhiku, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti në emër të GP të “Nismës për Kosovën”; Fikrim Damka, në emër të GP “6+”, Korab Sejdiu, Milaim Zeka, Xhevahire IzmaKu, Ismajl Kurteshi dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	50,
Kundër -----	9,
Abstenime -----	4.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operacionale prej 0,071% dhe taksës investive prej 0,381% për vitin 2018.

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjet e mbajtura, më 5 dhjetor 2017 dhe më 22 janar 2018, ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i dorëzojnë propozimet

për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar nga komuniteti shumicë-shqiptar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 69,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar nga komuniteti shumicë-shqiptar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Imet Rrahmani nga GP i LDK-së, kryetar,
2. Nait Hasani nga GP i PDK-së, zv/kryetar i parë,
3. Igor Simiq nga GP i LS-së, zv/kryetar i dytë,
4. Shqipe Pantina nga GP i LVV -së, anëtare,
5. Valon Ramadani nga GP i LVV -së, anëtar,
6. Fisnik Ismajli nga GP i LVV -së, anëtar,
7. Lirije Kajtazi nga GP i LDK-së, anëtare,
8. Blerta Deliu-Kodra nga GP i PDK-së, anëtare,
9. Rasim Selmanaj nga GP i AAK-së, anëtar,
10. Milaim Zeka nga GP i “Nismës për Kosovën” dhe
11. Albert Kinolli nga GP “6+”.

II. Komisioni ad hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për një (1) anëtar nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar nga komuniteti shumicë-shqiptar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2017, ka kërkuar nga grupet parlamentare që t’i dorëzojnë propozimet për kryetar,

zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqu nga GP i PDK -së, kryetare,
2. Shqipe Pantina nga GP i LVV -së, zv/kryetare e parë,
3. Albert Kinolli nga GP “6+”, zv/kryetar i dytë,
4. Valon Ramadani nga GP i LVV -së, anëtar,
5. Fisnik Ismajli nga GP i LVV -së, anëtar,
6. Arben Gashi nga GP i LDK -së, anëtar,
7. Armend Zemaj nga GP i LDK-së, anëtar,
8. Andin Hoti nga GP i PDK-së, anëtar,
9. Jelena Bontiq nga GP i LS, anëtare,
10. Rasim Selmanaj nga GP i AAK-së, anëtar dhe
11. Enver Hoti nga GP i “Nismës për Kosovën”, anëtar.

II. Komisioni ad hoc, në bazë të nenit 38 pika 2.2 dhe 2.3 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve, duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 25 janar 2018, në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendi

Kadri Veseli

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale